



Në mbështetje të neneve 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 28 e datës 04 qershor 2008, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 8, 14 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019 dhe nenit 13 të Rregullorës (QRK) Nr 09.2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës të datës 13.08.2020 dhe nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 08.05.2024, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

V E N D I M

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZONËN KADASTRALE BABUSH I MUHAXHERËVE

Neni 1

1. Me këtë Vendim jepen në shfrytëzim afatgjatë personave fizik dhe juridik paluajtshmeritë-pronat komunale që gjenden në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve të përshkruara si në vijim:

1.1. Njësia kadastrale P-71409059-00559-9 me sipërfaqe 40000 m² ZK Babush i Muhaxherëve, Komuna Lipjan

1.2. Njësia kadastrale P-71409059-00559-10 me sipërfaqe 20000 m² ZK Babush i Muhaxherëve, Komuna Lipjan

1.3. Njësia kadastrale P-71409059-00559-11 me sipërfaqe 10000 m² ZK Babush i Muhaxherëve, Komuna Lipjan

1.4. Njësia kadastrale P-71409059-00559-12 me sipërfaqe 13137 m² ZK Babush i Muhaxherëve, Komuna Lipjan

1.5. Njësia kadastrale P-71409059-00559-15 me sipërfaqe 11172 m² ZK Babush i Muhaxherëve, Komuna Lipjan

Neni 2

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave komunale siç përcaktohet në nenin 1 të këtij vendimi, bëhet në mënyrë që subjekteve të interesuara të i'u mundësohet të ofertojnë për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme të biznesit të cilat do të ndikonin në zhvillimin ekonomik të Komunës së Lipjanit, sipas standardeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 3

Pronat e paluajtshme komunale sipas nenit 1 të këtij Vendimi jepen në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite nëpërmjet procedurës së Njoftimit publik nga ana e Komisionit Vlerësues sipas Vendimit të Kuvendit Komunal.

Neni 4

Zgjedhja e ofertës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të komunës, bazohet në kriteret e përcaktuara në nenin 20 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që pas përfundimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës të paluajtshme të komunës sipas nenit 1 të këtij Vendimi të regjistroj në librat kadastral si pronë të dhënë në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite sipas procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset: Zyra e Kryetarit-Sektori Pronëso-ro-Juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Inspeksion.

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Nr. 15-h63/06-22761

Lipjan, më 08.05.2024

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Dauid Azemi



Page 2 / 3